

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"SYNRISE" SHPK

KREUI

Neni 1

Krijimi

Mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin "Per QKR", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, themeloj me vullnetin tim te lire shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar, me emertim "SYNRISE" shpk, , me ortak te vetem Znj. Luisiana Allaraj, i bija e Shkelqim dhe e Hanishe , i datelindjes 09.11.1986, lindur ne Kukes dhe banues ne Rruga e Kastrioteve, Kodrat e Insitutit , Tirane, shtetas shqiptare, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, i identifikuar sipas ligjit nepermjet ID:I66109060B

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "SYNRISE" shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne TIRANE.

Njesia Bashkiake nr.7, Rruga E Kavajes, Ndertesha Numer 50. Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqeria ka si objekt veprimtarie:

- Aktivitet ne zhvillimin software.
- Konsulence per IT(informatik).
- Analiza, dizenjimi dhe implementimi I aplikacioneve mobile.
- Dizenjimi dhe grafika e internetit.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqërise është Luisiana Allaraj me afat kohor 5 vjeçar.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërise.

Neni 11

Kompetencat

Shoqëria administrohet nga një Administrator i Vetëm. Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Administratori ka gjithashtu të drejte të nënshkruaje kontrata të ndryshme në emër e për llogari të Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruaje aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruaje e hartojë çdo dokument e të kryeje në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryeje veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohe të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërise në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.
Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper " .

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "SYNRISE" shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKU I VETEM

Luisiana Allaraj



Tirane: 06.04.2021